



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:081331
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05607682

CA.nr.3936/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Naime Ahmeti, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-propozuesit të sigurimit S.H. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Q.Z., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit N.SH.P. “..” me seli në Prishtinë, rruga “..”, kompleksi Q, numër .. si dhe F.A. nga Prishtina, rruga “..”, Kompleksi Qafa, numër 1/12, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson F.M. S, avokate nga Prishtina, për përmbushjen e kontratës dhe kompensimin e dëmit, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit–propozuesit të sigurimit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2078/2023 të datës 15.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit - propozuesit të masës së sigurimit S.H. nga Prishtina, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2078/2023 të datës 15.02.2024, VËRTETOHET .

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar C.nr.2078/2023 të datës 15.02.2024, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë të paditësit/propozuesit S.H. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë ashtu që t’ i ndalohet kundër propozuesit të parë NSHP “..” me seli në Prishtinë dhe kundër

propozuesit të dytë F.A. me vendbanim në Prishtinë, që të disponojnë në çfarëdo forme, ta shesin, ta fshehin, ta lënë hipotekën, ta tjetërsojnë apo ngarkojnë në çfarëdo forme, deri në përfundimin e kësaj çështje kontestimore me aktgjykim të plotfuqishëm, paluajtshmërinë – banesën me numër ..., kati i parë, me sipërfaqe 72.38 m², (banesa nr. ...), objekti ..., hyrja ..., e cila ndodhet në parcelën kadastrale numër ..., Zona Kadastrale Prishtinë, numri i fletës poseduese ..., lagja ..., blloku B6, objekti .. – Prishtinë, me etazhitet ... t'i bllokohen kundër propozuesit të parë NPSH "...” me seli në Prishtinë dhe kundër propozuesit të dytë F.A. me vendbanim në Prishtinë, llogaritë bankare në të gjitha bankat e licencuara në Republikën e Kosovës, deri në lartësinë prej 41,257.00 €, deri në përfundimin e kësaj çështje kontestimore me aktgjykim të plotfuqishëm”.

Kundër këtij aktvendimi paditësi – propozuesi i masës së sigurimit nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovohet ankesa e propozuesit të masës së sigurimit Suad Haliti, të anulohet në tërësi si i pabazuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të caktohet masa e sigurisë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit – propozuesit të sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi S.H. nga Prishtina, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 03.04.2023, në gjykatën e shkallës së parë, ka ushtruar padi për përmbushjen e kontratës dhe kompensimin e dëmit, kundër të paditurit N.SH.P "...”, me seli në Prishtinë dhe F.A. nga Prishtina me propozim që ndaj të paditurit – kundërshtarit të sigurimit të caktohet masa e sigurimit me kërkesë të përshkruar detajisht në paragrafin e parë të arsytimit të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit të propozuesit të masës së sigurimit me aktvendimin e atakuar C.nr.2078/2023 të datës 15.02.2024 e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsytim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297 të LPK, për shkak se propozuesi i masës së sigurisë nuk e ka bërë në masë të mjaftueshme të besueshme të drejtën subjektive të tij, e kjo ngase nga ekspertiza e gjeodezisë ka rezultuar se banesa kontestuese me të dhënat e përshkruara sikurse në para kontratën e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ekziston, andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar se pala propozuese nuk e ka bërë të besueshme të drejtën e saj subjektive mbi njësinë banesore në fjalë dhe si rrjedhojë propozimi i propozuesit është refuzuar.

Përkitazi me refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurisë në drejtim të bllokimit të llogarive bankare në të gjitha bankat e licencuara në Republikën e Kosovës, deri në lartësinë prej 41,257.00 €, gjykata e ka arsyetuar se nuk mund të caktohet masa e sigurimit që të bëhet bllokimi i llogarive bankare pa u vërtetuar e drejta subjektive e propozuesit, përkatësisht e drejta e kompensimit të dëmit dhe lartësia e tij. Ka shtuar poashtu se kundërshtari i parë i sigurimit është i regjistruar në regjistrat aktual të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe mbi këtë bazë pala propozuese nuk ka argumentuar me asnjë provë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurisë do t'i pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës.

Për mënyrën e vendosjes gjykata i është referuar dispozitës së nenit 300 dhe 304 paragrafi 3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në tërësi si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se sipas gjetjeve të gjykatës ankimore rezulton se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike rezulton të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë dhe se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të bëra nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të propozuesit të masës së sigurimit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme rreth mënyrës së vendosjes dhe fakteve vendimtare, ku një mënyrë e tillë e vendosjes sipas vlerësimit të gjykatës ankimore ka mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj dhe se aktvendimi i ankimuar sipas kësaj gjykate del se përmban të gjitha elementet ligjore të parapara me dispozitën e nenit 160 e lidhur me nenin 208 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se propozimi për caktim të masës së sigurimit nuk është i bazuar, përkatësisht nuk ka mbështetje ligjore.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në faktet e theksuara në arsyetim të aktvendimit të ankimuar rezulton të ketë pasur pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes, prandaj Gjykata e Apelit, vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e ka aprovuar në tërësi, për arsye se edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate në rastin konkret në bazë të provave nga shkresat e lëndës nuk kanë qenë të plotësuara kumulativisht kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit sikur është parashikuar me dispozitën e nenit 297 paragrafi 1, pika (a) dhe (b) të LPK-së.

Për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, sipas dispozitës së nenit 297 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LPK-së parashihet se duhet të plotësohen dy kushte kumulative. Kushti i parë është që propozuesi i sigurimit ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, ndërsa kushti i dytë është që të ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave ose do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesve të sigurimit.

Gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kanë qenë të plotësuara kumulativisht kushtet e parapara me dispozitat e sipërcituara ligjore për caktimin e masës së sigurimit. Kjo për faktin se në rastin konkret edhe në rast se propozuesi i sigurimit do ta bënte të besueshme të drejtën e tij subjektive mbi objektin e kontestit, i njëjti gjykatës nuk i ka ofruar prova se kundërshtari i sigurimit ka ndërmarrë ndonjë veprim për tjetërsimin apo ngarkimin me ndonjë barrë reale të paluajtshmërisë lëndore apo edhe se i njëjti është në situatë të pavolitshme financiare, e mbi bazën e të cilave veprime pastaj gjykata e shkallës së parë do të kishte mundësi që të vlerësonte ndryshe edhe kushtin e dytë ligjor të kërkuar sipas dispozitës së nenit 297 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, që i referohet rrezikut lidhur me dëmin eventual që mund t'i shkaktohej propozuesit të sigurimit si shkak i mos caktimit të masës së propozuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas këtij aktvendimi ka pasur parasysh dhe ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të palës ankuese rreth konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për të cilat kjo gjykatë ka vlerësuar se janë tërësisht të pabazuara, pasi që me shikim në shkresat e lëndës dhe analizimin e aktvendimit të ankimuar konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar në bazë të fakteve të theksuara në arsyetimin e aktvendimit rezulton të ketë pasur pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes duke vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike me rastin e vlerësimit të kushteve çoftë sa i përket të drejtës subjektive përkitazi me kërkesën e padisë për përmbushje të kontratës duke dhënë arsye të qarta se pse pala propozuese nuk e ka bërë të besueshme të drejtën e tij në raport me një kërkesë të tillë, ndërsa përkitazi me kërkesën e padisë për kompensimin e dëmit gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se një kërkesë e tillë del të jetë e përgjithësuar pa precizim konkret përkitazi me faktin se ku konsiston dëmi si dhe lartësia e tij. Gjykata e shkallës së parë poashtu ka vërtetuar gjendjen faktike edhe përkitazi me ekzistimin e rrezikut si kusht i dytë për caktimin e masës së sigurimit dhe se me të drejtë ka vlerësuar se propozuesi i sigurimit nuk ka argumentuar me asnjë provë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurisë do t'i pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës andaj gjykata me të drejtë e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, të cilin qëndrim e përkrah edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pavarësisht nga mënyra e vendosjes lidhur me propozimin për masë të sigurimit, vendosja meritorë për themelësinë e kërkesëpadisë mund të jetë tjetër nëse gjendja e fakteve të provuara përcakton se kërkesa e padisë është e themeltë.

Gjykata e Apelit ka vërejtur se gjykata e shkallës së parë në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar ka shënuar refuzohet si i pa bazuar propozimi për caktimin e masës *së përkohshme të sigurisë*, ndërsa nga arsyetimi i vendimit si dhe shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për masën e sigurimit (jo masën e përkohshme), mirëpo sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kjo përfaqëson një gabim teknik i cili nuk ka ndikim në përmbajtjen e vendimit, ngase dispozitivi i aktvendimit është i qartë e poashtu edhe në arsyetim të aktvendimit janë sqaruar dhe arsyetuar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes për refuzimin si të pa bazuar të masës së sigurimit pas mbajtjes së seancës së dëgjimit, andaj kjo gjykatë vlerësoi se një gabim i tillë i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë nuk ndikon në ligjshmërinë dhe drejtëshmërinë e vendimit.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.3936/2024, të datës 18.04.2024.

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka, d.v.